



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 15.02.2016,
e cila filloi në orën 14:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Flamur Shala (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Laura Zherka (PDK), Mirlinda Sopi (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR) dhe Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF.

Munguan: Abit Kastrati, Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Shaip Shabani (PDK), Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Abetare Fazliu (LB), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Nenad Miladinoviç, përfaqësues i subjektit politik GIS dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, i cili ngriti çështjen e rendit të ditës, duke thënë se në KPF është marrë qëndrim që në rend dite të futen edhe pikat:

- 1. Diskutimi për caktimin e lokacionit për varrezat dhe kishën protestante dhe**
- 2. Shqyrtimi i vendimit të peticionit të banorëve të lagjes "Prishtina e Re", pika të cilat janë hequr nga rendi i ditës.**

Lidhur me pikat që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Urbanizmit, ne e kemi marrë një shkresë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sipas së cilës del se nuk kemi të drejtë të procedojmë me pikat e urbanizmit, sepse duhet të bëhen disa punë të tjera e pastaj të procedohen këto pika.

Sami Hamiti, në emër të GP të LDK-së, propozoi që pikat: 2, 3, 4, 11, 12, dhe 13 të hiqen nga rendi i ditës. Njëherësh kërkoi që në rend dite të futet pika: **Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat dhe kishën protestante**. Gjithashtu propozoi që në Komisionin e aksionarëve në NPL "Prishtina Parking" në vend të z. Abit Kastrati të caktohet z. Muhamet Nura.

Lirak Qelaj, në emër të GP të PDK-së, propozoi që nga rendi i ditës të hiqen pikat: 2, 3, 4, 11, 12 dhe 13, ndërsa pika 5 të modifikohet dhe të jetë: **Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshimin-përshtatjen e profilit të rrugës "F-F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2", në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë.**

Remzi Pacolli, në emër të GP të AKR-së, propozoi që në rend dite të futet edhe pika: **Propozimvendimi për pagesën e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave, shesheve dhe vendbanimeve në komunën e Prishtinës.**

Flamur Shala propozoi që GP i LDK-së, por edhe Kuvendi, të dalin me një deklaratë, e cila do të përmbante shqetësimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës për injorimin që po i bëhet festës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, dhe mos gatishmërinë e Kryetarit të Komunës së Prishtinës për ta shënuar këtë datë historike për qytetarët e këtij vendi.

Ai kërkoi që kjo deklaratë të jetë në rend dite.

Për rendin e ditës diskutoi edhe **Visar Arifaj**, përfaqësues i subjektit politik Partia e Fortë, diskutimi i të cilit, bashkë me diskutimet e tjera janë dhënë të plota në transkript.

Me propozimet e dhëna nga GP i LDK-së, i PDK-së, i AKR-së dhe propozimin e Flamur Shalës, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e rendit të ditës.

Kryesuesi konstatoi se me 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 1 (një) abstenim (Visar Arifaj), u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit (2015) dhe të mbledhjes urgjente të Kuvendit (2016) ;
2. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për varrezat dhe kishën protestante;
3. Propozimvendimi për caktimin e një anëtari në Komisionin e aksionarëve në ndërmarrjen publike lokale "Prishtina Parking";
4. Propozimvendimi për pagesën e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave, shesheve dhe vendbanimeve në komunën e Prishtinës;
5. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshimin-përshtatjen e profilit të rrugës "F - F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2", në lagjen "Lakërishta" në

- Prishtinë;
6. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia";
 7. Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta;
 8. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës;
 9. Deklaratë me rastin e 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
 10. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të bashkësive lokale;
 11. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;
 12. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të një pjese të SHML "Gjimnazi Matematikor" për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme "Atomi";
 13. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private;
 14. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
 15. Propozimplani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
 16. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete;
 17. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
 18. Pyetje dhe përgjigje;
 19. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit (2015) dhe të mbledhjes urgjente të Kuvendit (2016).

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit (2015) dhe të mbledhjes urgjente të Kuvendit (2016).

Pika e dytë

Caktimi i lokacionit për varrezat dhe kishën protestante.

Lidhur me caktimin e lokacionit për varrezat dhe kishën protestante, diskutuan **Lirak Çelaj**, në emër të GP të PDK-së, **Sami Hamiti**, në emër të GP të LDK-së, **Remzi Pacolli**, në emër të GP të AKR-së dhe **Visar Arifaj**, përfaqësues i subjektit politik PF, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 28 (njëzet e tetë) vota për dhe 1 (një) abstenim (Visar Arifaj), në parim u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për varrezat dhe kishën protestante.

Pika e tretë

Caktimi i një anëtari në komisionin e aksionarëve në ndërmarrjen publike lokale "Prishtina Parking".

U konstatua se me 25 (njëzet e pesë) vota për, 3 (tri) abstenime (Remzi Pacolli, Mirlinda Sopi dhe Sofije Bunjaku) dhe 1 (një) votë kundër (Visar Arifaj), në vend të z. Abit Kastratit, ish-anëtar i LDK-së në Komisionin e aksionarëve në ndërmarrjen publike lokale " Prishtina Parking", caktohet z. Muhamet Nura.

Pika e katërt

Propozimvendimi për pagesën e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave, shesheve dhe vendbanimeve në komunën e Prishtinës.

Lidhur me këtë propozimvendim diskutuan **Sami Hamiti, Remzi Pacolli, Shefki Gashi** dhe **Lirie Avdiu**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

U konstatua se me 28 (njëzet e tetë) vota për dhe 1 (një) kundër (Visar Arifaj), u miratua Vendimi për pagesën e anëtarëve të Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave, shesheve dhe vendbanimeve në komunën e Prishtinës.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshimin-përshtatjen e profilit të rrugës "F - F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2", në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë.

Për këtë propozimvendim diskutuan **Muhamet Selmani** dhe **Sami Hamiti**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

U konstatua se njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshimin-përshtatjen e profilit të rrugës "F - F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2", në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regjional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia.

Për këtë pikë diskutuan **Sami Hamiti** dhe **Lirak Çelaj**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

U konstatua se njëzëri u miratua Vendimi për rikategorizimin e parkut regjional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia.

Pika e shtatë

Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Lidhur me këtë propozimrregullore diskutuan **Agim Gashi**, **Sofije Bunjaku**, **Lirie Avdiu**, **Flamur Shala** dhe **Sami Hamiti**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

U konstatua se me vërejtjet e dhëna, njëzëri u miratua Rregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Pika e tetë

Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.

Kryesuesi tha se në mungesë të përfaqësuesve të ekzekutivit, përkatësisht të drejtorisë përkatëse, meqë është një rregullore e një rëndësie të veçantë, propozoj që kjo të shtyhet për diskutim në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.

Pika e nëntë

Deklaratë me rastin e 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Flamur Shala, në emër të GP të LDK-së dhe në pajtim me grupet e tjera parlamentare, lexoi deklaratën lidhur me shqetësimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës lidhur me organizimin, shënimin e 8-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. (Teksti i deklaratës është dhënë i plotë në transkript).

Kryesuesi konstatoi se u përkrah deklarata.

Agim Gashi, shprehu mendimin se nuk janë përfillur procedurat për dhënien e pëlqimit për vendosjen e skenës dhe banerëve, por kishte edhe mëdyshje që Lëvizja

Vetëvendosje nuk ka bërë kërkesë për dhënien e pëlqimit për vendosjen e banerëve në shesh, sepse Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk ka të drejtë që një subjekti politik t'i japë tërë atë hapësirë publike jashtë fushatës zgjedhore. Banerët i kanë vendosur pa pëlqimin e organeve të Komunës.

Kryesuesi konstatoi se mbledhja përfundon në mungesë të kuorunit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Halim Halimi, jur. i dipl.